



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P.306/2021

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 23.06.2021 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Ardit” SHPK, në procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur”, Nr. REF-91232-03-25-2021, me objekt: Loti 1 “*Dru zjarri*”, me fond limit 9,005,000 (nëntë milion e pesë mijë) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 19.04.2021 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Devoll.

Ankimues: “Ardit” SHPK
Adresa: Drithas, Maliq

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Devoll
Adresa: Lagjja Nr. 1, Rruga “24 Tetori”, Nr. 9, Bilisht, Devoll

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i

Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”,

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Vlerësimi paraprak

1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomikë ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1, të nenit 63, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 26.03.2021 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur”, Nr. REF-91232-03-25-2021, me objekt: Loti 1 “Dru zjarri”, me fond limit 9,005,000 (nëntë milion e pesë mijë) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 19.04.2021 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Devoll.

II.2. Në datën 19.04.2021 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

II.3. Në datën 28.04.2021 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

- Ardit SHPK	8,005,000.00	I skualifikuar
- Spartak SA SHPK	8,914,950.00	I skualifikuar

II.4. Në datën 28.04.2021 operatori ekonomik “Ardit” SHPK është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi për arsye si më poshtë vijon:

- OE ofertues “ARDIT” SHPK nuk ka përmbushur kërkesat e pikës 2.3.5 ku- Ofertuesi duhet të deklarojë me anë të një deklarate që ka gjendje apo mund të sigurojë brenda periudhës së kërkuar sasinë e kërkuar të mallit.

Dhe për pikën 2.3.6 - Deklaratë e operatorit ekonomik që merr përsipër furnizimin me mjetet dhe kostot e veta në të gjitha pikat e përcaktuara në grafikun e shpërndarjes nga Autoriteti Kontraktor”.

II.5. Në datën 04.05.2021, operatori ekonomik ankimues ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e KVO-së për skualifikimin e ofertës së tij, në procedurën e mësipërme të prokurimit në mënyrë të përmbledhur me argumentet si më poshtë:

- Më datë 28.04.2021 mbas procesit të vlerësimit të ofertave për tenderit Lëndë djegëse (dru zjarri dhe pellet) u informuam nga autoriteti kontraktor Bashkia Devoll që oferta jonë është refuzuar sipas arsyes: “ofertues “ARDIT” SHPK nuk ka përmbushur kërkesat e pikës 2.3.5 ku- Ofertuesi duhet të deklarojë me anë të një deklarate që ka gjendje apo mund të sigurojë brenda periudhës së kërkuar sasinë e kërkuar të mallit. Dhe për pikën 2.3.6 - Deklaratë e operatorit ekonomik që merr përsipër furnizimin me mjetet dhe kostot e veta në të gjitha pikat e përcaktuara në grafikun e shpërndarjes nga Autoriteti Kontraktor”. Ju bëjmë me dije se kompania jonë këtë deklaratë e kemi plotësuar në dokumentet e dorëzuar nga ana jonë. Kjo deklaratë që ju keni kërkuar duke mos pasur shtojcë standard si deklaratat e tjera në dokumentet standarde të tenderit të cilën ne ta plotësonim ashtu si kemi plotësuar deklaratat e tjera të cilat të gjitha janë sipas shtojcave përkatëse kjo deklaratë është përfshirë nga ana jonë tek shtojca 6 –deklarata mbi përmbushjen e specifikimeve*

teknike. Nëse verifikoni shtojcën 6, ne kemi deklaruar 1. përmbushjen e specifikimeve teknike, 2. Ka gjendje dhe kryen realizimin e objektit dhe 3. Realizimin sipas grafikut të përcaktuar nga autoriteti kontraktor. Përfundimi juaj se kompania jonë nuk ka plotësuar deklaratë për realizimin e këtij furnizimi dhe sipas grafikut të përcaktuar nuk është e saktë”.

II.6. Në datën 10.05.2021 me shresën nr. 1445/4 prot operatori ekonomik ankimues ka marrë dijani lidhur me mospranimin e ankesës nga autoriteti kontraktor me argumentet si më poshtë:

- *Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Ardit” SHPK për përmbushjen në pikën 2.3.5 dhe 2.3.6 të dokumenteve të tenderit, Komisioni vëren se: Në dokumentet e tenderit, për të përmbushur pikën 2.3.5 Ofertuesi duhet të deklarojë me anë të një deklaratë që ka gjendje apo mund të sigurojë brenda periudhës së kërkuar sasinë e kërkuar të mallit dhe pikën 2.3.6 Deklaratë e operatorit ekonomik që merr përsipër furnizimin me mjetet dhe kostot e veta në të gjitha pikat e përcaktuara në grafikun e shpërndarjes nga Autoriteti Kontraktor. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të operatorit ekonomik “Ardit” SHPK, të dorëzuar në sistemin e prokurimeve elektronike, për të përmbushur kriteret e mësipërme, konstatohet se nuk është paraqitur asnjë dokumentacion për të përmbushur kërkesat e pikës 2.3.5 dhe 2.3.6 të dokumentave të tenderit. Për operatorin ekonomik “Ardit” SHPK, shtojca 6 është vlerësuar për përmbushjen e pikës 2. Kriteret e veçanta të kualifikimit, pika 1. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë: ç. Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, sipas shtojcës 6. Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron”.*

II.7. Në datën 17.05.2021 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtën objekt me ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor.

II.8. Nëpërmjet shkresës nr. 1636/1 prot., datë 04.05.2021, protokolluar me tonën me nr. 841/2 prot., datë 28.05.2021 me objekt “Dërgohet informacioni”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumenteve të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “Ardit” SHPK mbi kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij, me arsyetimin se “[...]Më datë 28.04.2021 mbas procesit të

vlerësimit të ofertave për tenderit Lëndë djegëse (dru zjarri dhe pellet) u informuam nga autoriteti kontraktor Bashkia Devoll që oferta jonë është refuzuar sipas arsyes: “ofertuesi “ARDIT” SHPK nuk ka përmbushur kërkesat e pikës 2.3.5 ku- Ofertuesi duhet të deklarojë me anë të një deklarate që ka gjendje apo mund të sigurojë brenda periudhës së kërkuar sasinë e kërkuar të mallit. Dhe për pikën 2.3.6 - Deklaratë e operatorit ekonomik që merr përsipër furnizimin me mjetet dhe kostot e veta në të gjitha pikat e përcaktuara në grafikun e shpërndarjes nga Autoriteti Kontraktor”. Ju bëjmë me dije se kompania jonë këtë deklaratë e kemi plotësuar në dokumentet e dorëzuar nga ana jonë. Kjo deklaratë që ju keni kërkuar duke mos pasur shtojcë standard si deklaratat e tjera në dokumentet standarde të tenderit të cilën ne ta plotësonim ashtu si kemi plotësuar deklaratat e tjera të cilat të gjitha janë sipas shtojcave përkatëse kjo deklaratë është përfshirë nga ana jonë tek shtojca 6 –deklarata mbi përmbushjen e specifikimeve teknike. Nëse verifikoni shtojcën 6, ne kemi deklaruar 1. përmbushjen e specifikimeve teknike, 2. Ka gjendje dhe kryen realizimin e objektit dhe 3. Realizimin sipas grafikut të përcaktuar nga autoriteti kontraktor. Përfundimi juaj se kompania jonë nuk ka plotësuar deklaratë për realizimin e këtij furnizimi dhe sipas grafikut të përcaktuar nuk është e saktë [...], Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në shtojcën 9 “Kriteret e veçanta të kualifikimit” pikat 2.3.5 dhe 2.3.6 “Kapaciteti teknik” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

“2.3.5 Ofertuesi duhet të deklarojë me anë të një deklarate që ka gjendje apo mund të sigurojë brenda periudhës së kërkuar sasinë e kërkuar të mallit.

2.3.6 Deklaratë e operatorit ekonomik që merr përsipër furnizimin me mjetet dhe kostot e veta në të gjitha pikat e përcaktuara në grafikun e shpërndarjes nga Autoriteti Kontraktor”.

III.1.2. Në shtojcën 10 “Specifikimet teknike” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet si më poshtë:

Loti 1: “Dru zjarri”

Specifikimi i druve:

- *Drutë e zjarrit të jenë të llojit ahu.*
- *Gjatësia e drurit të jetë 90 cm -100 cm dhe trashësia jo më pak se 10 cm (këto specifikime do jenë objekt i njësisë matëse ,”m/stere” nga Komisioni i marrjes në dorzim të mallit.*
- *Të mos jenë të kalbura dhe të jenë të thata.*
- *Drutë duhet të priten në formë të përshtatshme për pore vertikale (gjatësi 30-32 cm)*

- Subjekti të marrë përsipër transportimin, stivimin, prerjen dhe carjen e drurëve në institucionet përkatëse me mjetet, shpenzimet dhe puntorët e tij sipas preventivit në shtojcën 12” .

III.1.3. Në nenin 46, pika 1, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese”*.

Në nenin 53/3 të LPP-së përcakohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit”*.

Ndërsa, në nenin 27, pika 3 të VKM Nr.914, datë 29.12.2014, i ndryshuar, përcakohet se: *“Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve”*.

III.1.4. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.1.5. Gjithashtu një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 2 i ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës barazisë, dhe mosdiskriminimit janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato.

III.1.6. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të procedurës së ankimuar, të administruar pranë KPP, si dhe bazuar në pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, konstatohet se në pikën 2.3.6 të dokumenteve të tenderit si dhe në specifikimet teknike të procedurës së prokurimit objekt ankimi është kërkuar që, *subjekti të marrë përsipër transportimin, stivimin, prerjen dhe carjen e drurëve në institucionet përkatëse me mjetet, shpenzimet dhe puntorët e tij sipas*

preventivit në shtojcën 12. Nga verifikimi i dokumenteve të operatorit ekonomik “Ardit” SHPK, konstatohet se, dokumenti shtojca nr. 6 e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues, është deklaratë për përmbushjen e specifikimeve teknike dhe realizimin e objektit sipas grafikut të lëvrimit dhe nuk përmbush kriterin 2.3.6 të dokumenteve të tenderit dhe kërkesën sipas specifikimeve teknike në shtojcën nr. 10 që është për furnizimin me mjetet dhe kostot e operatorit ekonomik për të gjithë pikat e përcaktuara në grafikun e shpërndarjes nga autoriteti kontraktor. Ndërkohë, nga dokumentacioni i paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni konstaton se, nuk ka paraqitur asnjë dokument tjetër provues për plotësimin e këtij kriteri. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, autoriteti kontraktor, me të drejtë ka skualifikuar operatorin ekonomik ankimues pasi deklarata e shtojcës nr. 6 e paraqitur prej tij, nuk është në përputhje me plotësimin e kriterit 2.3.6 dhe të specifikimeve teknike sipas shtojcës nr. 10 të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi. Konkretisht, deklarata sipas shtojcës nr. 6 është në përmbajtje dhe qëllim të ndryshëm nga ajo e kërkuar në kriterin 2.3.6 dhe në kërkesën në specifikimet teknike shtojcës nr. 10 të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi. Komisioni thekson se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Në rastin konkret, Komisioni referuar deklaratës sipas shtojcës nr. 6 të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues për këtë procedurë prokurimi, gjykon se, nuk mund të konsiderohen se përmbush kërkesat sipas kriterit në pikën 2.3.6 dhe specifikimeve teknike (shtojca nr. 10), të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit.

III.1.7. Gjithashtu, Komisioni sqaron, se nëse operatori ekonomik do të kishte pretendime në lidhje me kriteret/specifikimet teknike të vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit ka patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesës, parashikuar nga neni 63, pika 1/1 e LPP. Në nenin 63, pika 1/1 të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se *“Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni”*.

Gjithashtu, kuadri ligjor parashikon një sërë elementesh si garanci për operatorët ekonomikë, të cilët kanë paqartësi në lidhje me interpretimin e kërkesave të autoritetit kontraktor dhe/ose

mënyrës së plotësimit të kriterëve kualifikuese. Në rast se, operatorët ekonomikë do të kishin paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesës së mësipërme, kanë patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në pesë ditë para dorëzimit të ofertave parashikuar nga neni 42 i LPP-së. Në nenin 42, pika 1 të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se “ [...] *Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ia komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit [...]*”.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Ardit” SHPK nuk qëndron.

III.1.8. Lidhur me pretendimet e tjera të operatorit ekonomik ankimues “Ardit” SHPK ndaj vendimit të KVO-së për skualifikimin e ofertës së tij, në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, për sa kohë që pretendimi i mësipërm nuk qëndron dhe gjendja e tij faktike juridike pas arsytimit të K.P.P. do të jetë e skualifikuar, shqyrtimi në themel i pretendimeve të tjera të palës ankimuese nuk ndryshojnë gjendjen juridike të këtij operatori ekonomik, e për rrjedhojë nuk do të merren në shqyrtim në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Ardit” SHPK për procedurën e prokurimit, “Procedurë e Hapur”, Nr. REF-91232-03-25-2021, me objekt: Loti 1 “Dru zjarri”, me fond limit 9,005,000 (nëntë milion e pesë mijë) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 19.04.2021 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Devoll
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.

3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.

4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 841 Protokolli, Datë 17.05.2021.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar	Anëtar	Anëtar
Vilma Zhupaj	Lindita Skeja	Merita Zeqaj

Kryetar
Jonaid Myzyri